

Emri i Lëndës : Reklama dhe Promocioni

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 569	C	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	6.00
Përgjithësia e informacioneve të lëndës:							
Lektori	Ana Kekezi, PhD						
Asistenti							
Gjuha e kursit	Shqip						
Niveli i lëndës	Master						
Pëershkrimi	<p>Kjo lëndë i ofron studentëve një mundësi për të kuptuar promocionin dhe reklamimin, si dhe mënyrat e tjera të komunikimit masiv. Në këtë kurs do të nijhen me konceptet baze te komunikimit të integruar. Lënda u jep mundë studentëve të nijhen me konceptet bazë të reklamës dhe promocionit. Lënda është e konceptuar në atë mënyrë që studentët, krahas aspekteve teorike të përfitojnë edhe njohuri praktik mbi aplikimin e reklamës dhe promocionit në ditët e sotme.</p>						
Objektivat	<p>Zhvillimi i Mendimit Strategjik: Të pajisen studentët me aftësi për të hartuar dhe vlerësuar strategjitet e reklamimit dhe promovimit në një treg konkurruesh. Kuptimi i Parimeve të IMC: Prezantimi i parimeve të Komunikimit të Integruar të Marketingut (IMC) dhe zbatimi i tyre në krijimin e fushatave të qëndrueshme. Analiza e Sjelljes së Konsumatorëve: Rritja e aftësisë së studentëve për të analizuar perceptimet e konsumatorëve dhe ndikimin e tyre në vendimet e reklamimit dhe promovimit. Zotërimi i Zhvillimit Kreativ: Nxitja e kreativitetit në zhvillimin e koncepteve, shkrimin e përbajtjes dhe tregimin vizual për qëllime reklamimi. Vlerësimi i Planifikimit të Medias: Ofrimi i ekspertizës për zgjedhjen, planifikimin dhe vlerësimin e kanaleve mediatike për shpërndarje efektive të fushatave. Përfshirja e Strategjive Dixhitale: Eksplorimi i rolit të marketingut dixhital dhe platformave të mediave sociale në reklamimin dhe promovimin modern. Matja e Performancës së Fushatave: Mësimi i metodave për vlerësimin e efektivitetit dhe ROI të fushatave reklamuese. Adresimi i Çështjeve Etike: Thesimi i implikimeve etike dhe kulturore të reklamimit në kontekste globale të ndryshme. Zbatimi Praktik: Zhvillimi i aftësive për krijimin dhe menaxhimin e projekteve reklamuese përmes studimeve të rasteve dhe projekteve në grup. Promovimi i Mësimit të Përjetshëm: Inkurajimi i mendimit kritik dhe adaptimit të vazhdueshëm ndaj trendeve të reja në industrinë e reklamimit.</p>						
Konceptet Kryesore	Komunikim i Integruar i marketingut Promocioni Imazhi i markës Pozicionimi i markës Planifikimi dhe blerja e hapësirës në media Sjellja konsumatore Kreativiteti						

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Konceptet bazë të reklamës dhe promocionit, historiku dhe përkufizimet kryesore. Reklamimi dhe format e tjera të promocionit janë një pjesë integrale e procesit të marketingut në shumicën e organizatave dhe kompanive të biznesit. Përkufizjet dhe qasjet mbi konceptet kryesore te komunikimit të integruar të marketingut. Prezantimi i literaturës dhe burimeve bazë të lëndës, prezantimi i syllabus dhe mënyrës së vlerësimit. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion", 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq.2-42 Robyn Blakeman, Integrated Marketing Communications; Creative Strategy from Idea to Implementation, Third Edition, Rowman & Littlefield, 2018, fq. 3-17
2	Hyrje në strategjinë e komunikimeve të integruara të marketingut. IMC përfshin kontatket me audiencën. Ekzistojnë mënyra shtesë që kompanitë të komunikojnë me klientët aktualë dhe potencialë. Këto mënyra shtrihen përtëj mësuarit tradicional të promocionit. Koncepti i pikës së kontaktit. Touch Point Perspective: Pika e kontaktit i referohet çdo mundësie që klienti ka për të parë ose dëgjuar për kompaninë dhe / ose markat e saj. Koncepti : Paid, Owned, Earned Media. Avantazhet dhe disavantazhet e se cilës. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion", 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq.10-68

3	<p>Roli i komunikimit të integruar në procesin e marketingut. Kuptimi i procesit të marketingut dhe rolit të reklamimit dhe promocionit në programin e intergruar të marketingut të një organizate. Prenzatimi i hapave për strategjinë e marketingut. Analiza e mundësive dhe analiza e Analiza e konkureshmërisë. Identifikimi I tregjeve me nevoja të pa plotësuara, përcaktimi i segmentimit të tregut, përgjedhja e tregut të targetuar, pozicionimi nëpërmjet strategjive të marketingut. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq. 42-66</p>
4	<p>Organizmi i reklamës dhe promocionit; roli i agjenisve të reklamës dhe aktorëve të tjerë të komunikimit të marketingut. Kuptimi i mënyrës si organizohen kompanitë për reklimin dhe aspekte të tjera të komunikimit të integruar të marketingut. Analizimi i metodave për përgjedhjen, kompensimin dhe vlerësimin e agjensive të reklamave. Rol i funksionimit i organizatave të komunikimit të marketingut. Njohja me pjesëmarrësit në Procesin e Komunikimit të Integruar të Marketingut George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq. 68-106</p>
5	<p>Sjellja e konsumatorit mund të përkufizohet si procesi dhe tèresia e aktiviteteve me të cilat njerëzit angazhohen kur kërkojnë, zgjedhin, blejnë, përdorin, vlerësojnë dhe skualifikojnë produkte apo shërbime, në mënyrë që të plotësojnë nevojat dhe dëshirat e tyre. Vendimi për të kryer një transakzion (blerje) mund të jetë rezultat i një procesi të gjatë dhe të detajuar, i cili mund të përfshijë brenda vetes disa etapa, që përmbyllen me vlerësimin. Njohja me rolin që luan sjellja e konsumatorëve në zhvillimin dhe zbatimin e reklamave dhe programeve promocionale. Njohja me proceset e ndryshme të brendshme psikologjike, ndikimi i tyre në vendimmarrjen e konsumatorit, dhe implikimet për reklamim dhe promovim. Shqyrtimi i qasjeve të ndryshme për të studiuar procesin e të mësuarit të konsumatorit dhe implikimet e tyre për reklamim dhe promovim. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq 110- 140</p>
6	<p>Fokusimi te rëndësia dhe vlera e përcaktimit të objektivave specifikë për planin e promocionit si dhe kuptimi i rolit që objektivat luajnë në procesin e planifikimit të IMC dhe marrëdhënien midis objektivave të promocionit dhe objektivave të marketingut. Dallimi mes objektivave të shitjes dhe komunikimit. Njohja me problematikat me të cilat përballen profesionistët e marketingut në përcaktimin e objektivave të programit IMC. Analizimi i konceptit "Piramida e efekteve të komunikimit". Përcaktimi i objektivave të reklamimit për rezultate të matshme të reklamimit, sipas modeli "Dagmar. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2018 fq 215-230</p>
7	<p>reklamë. Zhvillimi i strategjisë kreative dhe rolin e klientëve apo personelit të agjensisë, të përfshirë në procesin kreativ. Njohja me procesin që udhëzon krijimin e mesazheve reklamuese dhe të dhënat kërkimore në fazat e procesit kreativ. Shqyrtimi i qasjeve të ndryshme të përdorura për përcaktimin e ideve të mëdha të shitjes që formojnë bazën e një fushate reklamuese. Modeli i Young i procesit kreativ me 5 hapa dhe procesi 4 hapësh, i sociologut Graham Wallas. Koncepti i Propozimit unik të shitjes unique selling proposition (USP). George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12 Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq 254 -280 Integrated Marketing Communications; Creative Strategy from Idea to Implementation, Robyn Blakeman, Third Edition, Roman & Littlefield, 2018 fq 53- 75</p>
8	<p>Provim Gjysmëfinal</p>
9	<p>Strategjia dhe planifikimi i media. Tterminologjinë kryesore e përdorur në planifikimin e medias. Njohja me etapat e hartimit të një media plan. Planifikimi i medias është një proces kompleks. Zhvillimi i mediave alternatitive, platformat e ndryshme të rrjeteve sociale, motorrët e kërkimit dhe mundësítë e tjera që ofron media interaktive, e bëjnë dhe më të vështirë këtë proces. Planifikimi i medias është seria e vendimeve që ndërrmerren gjatë përcjelljes së mesazhit promocional te blerësit potencial ose përdoruesit ekzistues, të një produkti apo një marke. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq 324-360</p>
10	<p>Marketingu i drejtpërdrejtë është një sistem i marketingut me të cilin organizatat komunikojnë drejtpërdrejt me klientët e synuar për të gjeneruar një përgjigje ose transaksion. Njohja me marketingun e drejtpërdrejtë dhe rolin e tij si një mjet komunikimi. Për shumë kompani dhe organizata, marketingu i drejtpërdrejtë është një element kryesor në programin e tyre IMC. Identifikojmë strategjitë dhe taktikat në përdorimin e marketingut të drejtpërdrejtë. Analizë krahasuese për të evidentuar avantazhet dhe disavantazhet e marketingut të drejtpërdrejtë. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq 460-475 Integrated Marketing Communications; Creative Strategy from Idea to Implementation, Third Edition, Rowman & Littlefield, 2018, fq. 230-250</p>

11	Reklama dhe promocioni në internet dhe mediat interaktive. Cili është roli i internetit dhe mediave sociale në një program të komunikimit të integruar të marketingut. Diskutim rreth përdorimit të platformave të mediave Web 1.0 dhe Web 2.0 në procesin e IMC (Komunikimi i integruar i marketingut). Metodat e vlerësimit të efektivitetit në lidhje me komunikimin përmes Internetit dhe mediave sociale. Krahasimi i avantazheve dhe disavantazheve të internetit dhe medias sociale. Dilemat etike që lidhen me internetin dhe median sociale dhe përdorimin e tyre në programet dhe strategjitet e komunikimit të integruar të marketingut. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion", 1thEdition, McGraw-Hill Education, 2021 fq 478-505 Integrated Marketing Communications; Creative Strategy from Idea to Implementation, Third Edition, Rowman & Littlefield, 2018, fq. 260-290
12	Matja e efektivitetit të programit promocional. Vlerësimi dhe matja e efektivitetit të programit apo strategjisë së reklamës dhe promocionit është një element thelbësor në procesin e planifikimit të komunikimit të integruar të marketingut. Kërkimi i lejon menaxherit të marketingut të vlerësojë performancën e elementeve specifikë të programit dhe të sigurojë kontribut në analizën e situatës së periudhës tjetër. Shqyryimi i mjeteve dhe proceseve të disponueshme për vlerësimin e efektivitetit të programit promovues. Njohja me kufizimet e metodave aktuale për matjen e efekteve të reklamimit. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12 Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq 478-505
13	Aspektet etike të reklamës dhe promocionit. Reklama është një instrument i fuqishëm komunikimi dhe bindjeje dhe ka qenë shpesh në qendër të kritikave në lidhje me ndikimin e tij social dhe ekonomik. Ekspertët e marketingut shpesh duhet të marrin vendime në lidhje me veprimet e duhura dhe të përgjegjshme në bazë të normave etike dhe profesionale. Kritika ndaj reklamave ka të bëjë me teknikat dhe metodat specifike të përdorura, si dhe efektin e saj në vlerat shoqërore, shijet, stilin e jetës dhe sjelljen. Është e rëndësishme njojha e këndvështrimeve të ndryshme mbi etikën e reklamimës dhe promocionit.. Etika ka të bëjë me parime dhe vlera morale që rregullojnë veprimet dhe vendimet e një individi ose grupei. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq 592-604
14	Një nga zhvillimet më të mëdha në botën e biznesit gjatë disa dekadave të fundit ka qenë globalizimi i tregjeve. Shfaqja e një bote kryesisht pa kufij ka krijuar një realitet të ri për të gjitha llojet e kompanieve. Reklam dhe promocioni në kontestin ndërkombëtar. Analizimi i rolit dhe rëndësisë së marketingut ndërkombëtar dhe promovimit. Diskutim mbi faktorët ekonomikë, kulturore, juridikë, etj, në mjeshterin ndërkombëtar ndikojnë në reklamimin dhe vendimet promocionale. Krahasimi mes reklamimës në konteksttin ndërkombëtar dhe atij lokal. George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq. 630 - 662
15	Prezantimi i projekteve semstrale studentëve. Analizë e gjetjeve të punës kërkimore të studentëve. Diskutim mbi tendencat e kërkimit dhe qasjet teorike mbi reklamën dhe promocionin. Vleresimi i etikes aspekteve sociale dhe ekonomike George E. Belch; Michael A. Belch, "Advertising and Promotion" , 12 Edition, McGraw-Hill Education, 2021 fq. 713-740
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	<ul style="list-style-type: none"> • Advertising and Promotion, George E. Belch; Michael A. Belch, 12th Edition, McGraw-Hill Education, 2021 • Integrated Marketing Communications; Creative Strategy from Idea to Implementation, Robyn Blakeman, Third Edition, Roman & Littlefield, 2018 • Arens, W. F., Weigold, M. F., & Arens, C. (2022). Contemporary Advertising and Integrated Marketing Communications (16th ed.) • Clow, K. E., & Baack, D. E. (2021). Integrated Advertising, Promotion, and Marketing Communications (8th ed.) • Moriarty, S., Mitchell, N., & Wells, W. (2020). Advertising & IMC: Principles and Practice (11th ed.)
Referanca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • Integrated Marketing Communications, David Pickton; Amanda Broderick, Second edition, Pearson Education, 2005 • Advertising and Promotion, Chris Hackley, SAGE Publications, 2005 • Barry, P. (2016). The Advertising Concept Book: Think Now, Design Later (3rd ed.). New York, NY: Thames & Hudson
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Në përfundim të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të njojin teoritë dhe konceptet kryesore mbi reklamën dhe promocionin
2	Studentët do të përvetësojnë njohuri mbi komunikimin e integruar dhe aplikimin e reklamës në përputhje me këtë koncept
3	Studentët do të përfitojnë njohuri mbi sjelljen e konsumatorëve, procesin vendimmarrës te konsumatorët dhe hierarkinë e nevojave
4	Studentët do të jenë në gjendje të hartojnë dhe zbatojnë planin e reklamës dhe promocionit

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	40
Kuize	0	0
Projekte	1	10
Projekte semestrale	0	0
Punë laboratori	0	0
Pjesëmarrja në mësim	0	0
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final	50	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final	50	
Total	100	

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	1	9	9
Gjysmë finale	1	15	15
Provimi final	1	20	20
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00